



Për ju që do të studjoni SFI, svenska för invandrare, (shqip suedishtja për të huaj)

Kursi SFI është një kurs bazal i suedishtes. Qëllimi është që ju përmes sfi-së të mësoni aq mirë suedishten saqë të mundeni t'ia dilni mirë në komunitet dhe në punë. Qëllimi është madje që ju të mundeni të vazhdoni studimet në nivelin bazë SVA, svenska som andra språk (shqip, suedishtja si gjuhë e dytë) në nivel themelor. Gjatë studimeve SFI ju do të takoni një konsulent të fushës së studimit dhe profesionit. Konsulenti në fushën e studimit dhe të profesionit do t'ju ndihmojë në përzgjedhjen e shkollimit të duhur deri tek puna juaj e ardhëshme.

Shkolla SFI në Tumba

Pasi të keni aplikuar për në kursin SFI, ju do t'ju caktohet termini për tek linguisti. Linguisti do t'ju shtrojë pyetje rreth begraundit tuaj dhe do ju bëjë një test të thjeshtë gjuhësor. Është linguisti ai i cili më pas vlerëson se në cilin shteg studimor dhe në cilin kurs ju do të shkoni.

SFI në Suedi përmban tre shtigje: shtegu 1,2 dhe 3, dhe katër kurse, kursin A, B, C dhe D.

Shtegu 1 fillon me kursin A, shtegu 2 fillon me kursin B, kurse shtegu 3 fillon me kursin C. Pas çdo kursi ju do të bëni testin dhe do të merrni notë. Për të filluar studimet në një kurs të ri ju nevojitet patjetër nota nga kursi i përparshëm. Ne ofrojmë SFI në kohështrirje dite, mbrëmje, të shtunave dhe me korrespondencë.

Kursi B dhe C i SFI-së fillon me një **Kurs hyrës** i cili zgjat pesë javë. Këtu ju ofrohet një hyrje në gjuhën suedeze. Këtu gjithashtu merret informacion rreth shkollës dhe kurset të ndryshme SFI të cilat i ofron shkolla. Bashkë me mësuesin ju do të hartoni një plan të studimit, **planin individual studimor** i cili i jep formën studimeve tuaja të gjuhës.

Në kursin C ju do të keni mundësi që të kombinoni studimet SFI me një kurs profesional. Nëse jeni të interesuar të dini më tepër se cilat **kurse profesionale** ofrohen nga shkolla SFI në Tumba ju mund të flisni me mësuesin tuaj ose me sportelin receptiv të shkollës. Recepcioni gjindet në katin 3.

Në SFI marrin pjesë gra dhe burra nga fe, kultura, begraunde dhe me preferenca seksuale të ndryshme. Këtu gëzojnë të gjithë respekt dhe konsideratë.



Të mësosh një gjuhë të re

På Tek SFI në Tumba ju do të studjoni në grupe të mëdha dhe të vogla. Ndonjëherë ju do të punoni në mënyrë të pavarur dhe ndonjëherë bashkë me të tjerë, brenda dhe jashtë shkollës.

Në SFI ne flasim gjithmonë suedisht në klasë. Përpiquni që gjithmonë të flisni suedisht, sa më shpesh që të jetë e mundur.

Në SFI mësuesit përdorin mjete të ndryshme asistuese. Këto mund të jenë mjete mësimore për studime SFI por mund të ketë dhe gazeta, medime sociale, programe gjuhësore, blogje, iPad dhe kompjutera.

Në SFI ne përdorim Google Clasroom e cila është një platformë e mirë mësimore. Ju do t'ju jepen të dhënat për log-in kur do filloni kursin.

Jeni ju ai i cili është përgjegjës për studimet tuaja

Me rëndësi është që të **vini me kohë** dhe të merrni pjesë aktivisht në orën e mësimit. Gjithashtu është me rëndësi që t'i bëni detyrat e shtëpisë dhe të përsëritni atë që keni mësuar.

Është përgjegjësia e juaj nëse sëmureni ose nëse nuk merrni pjesë më mësimore ndonjë ditë. Lajmëroni gjithmonë mësuesin nëse nuk merrni dot pjesë. Nëse ju paraqitet problem me pjesëmarrjen tuaj në SFI, ju dhe mësuesi juaj mund të gjeni bashkë një zgjidhje më të mirë për studimet tuaja.

Studimet i merrni në taktin tuaj

Ne pranojmë nxënës të rinj çdo të pastën javë ndaj nxënësit tanë fillojnë dhe mbarojnë kursin në data të ndryshme. Kursi i juaj përfundon tek kur ju të keni realizuar objektivin dhe se kur ndodh kjo, varion nga personi në person. Shkolla ka një kohëzgjatje të caktuar maksimale për çdo nxënës dhe kjo varet se cilit shteg ju i përkisni. Nëse mësuesi konsideron se ju rrezikoni të mbeteni pa marë kursin në kohë atëherë vendosen masa.

Në fund të kursit ju do t'i nënshtrohëni Provimit Kombëtar, NP dhe është mësuesi i juaj ai i cili vendos se ju jeni gati për këtë. Kur kursi të ketë përfunduar ju merrni notën.

Është me rëndësi të kuptoni se për të mësuar një gjuhë të re merr kohë.



Mbani mend se:

- Nuk ju lejohe të merrni fëmijët tuaj në shkollë.
- Mosardhja e juaj në SFI rezulton në mungesë. Nuk lejohe mungesë më e lartë se 21 ditë. Lajmëroni gjithmonë shkollën po të jeni sëmurë ose jeni me pushime.
- Mashtrimi gjatë provimit në SFI është rreptësisht i ndaluar.
- Nga konsiderata për alergjikët nuk lejohe përdorimi i tepërt i parfumit në shkollë.
- Duhani lejohe vetëm në vendet e parapara jashtë oborrit të shkollës.
- Nëse aktivizohet alarmi i zjarrit, ju do të shkoni shpejt deri tek dalja më e afërt e emergjencës dhe do të dilni jashtë tek vendparkimi i madh jashta shkollës SFI. Lini të gjitha gjësendet.

Mirësevini në SFI, në kuadër të Vuxenutbildningen (shqip, Arsimimi për të rritur), në Komunën Botkyrka!